

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Formulari i njoftimit të fituesit

“D&C PARTNERS” shpk
Rr.Urani Pano P.i Firmës Cani Kati II, Zyra 8 Tiranë

Procedura e prokurimit: “Supervizion punimesh, Plotësim, rakordim, masa mbrojtëse dhe siguri rrugore në viaduktet e aksit Kukës-Morinë”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-76367-06-26-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Fondi limit 2,469,160.16 lekë (pa TVSH), Kohëzgjatja e kontratës 8 muaj.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Datë 02.07.2018, Nr.26.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

Nr.	Operatori ekonomik	Nipt	Vlera pa Tvsh	Vlera me fjalë
1.	D&C PARTNERS shpk	K41531001K	2 400 000	Dy milion e katërqind mijë

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

Nr.	Operatori ekonomik	Nipt
1.	AVE CONSULTING shpk & ROALB STUDIO shpk	K81321002M L16421701H
2.	INFRATECH shpk	K91628001D
3.	INSTITUTI I KONSULENCËS NË NDËRTIM shpk & GOLD-CONSTRUCTION shpk	K71828007J L06727004E

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “AVE CONSULTING shpk & ROALB STUDIO shpk” nuk plotëson kriteret e mëposhtme të përcaktuara në dokumentet e tenderit:

-Operatori ekonomik "Roalb Studio" nuk ka paraqitur Vërtetim nga OSHEE për pagesën e detyrimit për energjinë elektrike;

-Shtojca nr.9 nuk është konform kriterit pasi në të gjitha deklaratat personi që deklaron është i njëjtë (Arben Dervishaj), ndërkohë që është nënshkruar nga secili anëtar i stafit të deklaruar;

-Operatori ekonomik "Roalb Studio" nuk ka paraqitur shtojcën nr.9;

-Në listëpagesat e paraqitura nga "Roalb Studio" nuk janë të deklaruar të gjithë drejtuesit teknikë të shoqërisë, në kundërshtim me kërkesën në DST.

2. Operatori ekonomik "INFRATECH" nuk plotëson kriterin e mëposhtëm të përcaktuar në dokumentet e tenderit:

-Nuk ka paraqitur shtojcën nr.7 konform kërkesave në DST.

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "INSTITUTI I KONSULENCËS NË NDËRTIM shpk & GOLD-CONSTRUCTION shpk" nuk plotëson kriterin e mëposhtëm të përcaktuar në dokumentet e tenderit:

-Operatori ekonomik 'IKN' shtojcën nr.8 "Deklarata mbi konfliktin e interesit" nuk e ka plotësuar konform dokumentit standard pasi nuk është e nënshkruar nga personi në cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik "Juliana Rec" por nga z.Saimir Mysliu.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "**D&C PARTNERS shpk**", me Nr.Nipt *K41531001K* dhe me adresë *Rr.Urani Pano, P.i Firmës Cani, Kati II, Zyra 8, Tiranë*, se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 87.73 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, *Rr.Sami Frashëri nr.33, Tiranë (Sektori i Prokurimeve, Zj.Anila Halili)* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 20.08.2018.

Ankesa: (ka ose jo) *Nuk ka*.